



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2024:074856

Datë: 12.02.2025

Numri i dokumentit: 06838626

**2024:074857**

### NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL**, me gjyqtaren e vetme gjyquese Fitore Krivanjeva-Daci, me procesmbajtëse Egzona Livoreka-zyrtare ligjore, në çështjen penale kundër të akuzuarit B.B nga Prishtina, për shkak të veprës penale, Kanosja nga neni 181 paragrafi 2, të KPRK-së, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj-Departamenti i Përgjithshëm, me numër PP.II.Nr.254/2024 të datës 05.03.2024, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor më datë 23.01.2025, në prani të Prokurorit të shtetit Besnik Nuredini, të dëmtuarit I.A dhe të akuzuarit B.B, më datë 24.01.2025, mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 12.02.2025, përpiloi me shkrim këtë:

### A K T G J Y K I M

#### I akuzuari:

**B.B**, i lindur me datë 21.06.1987 në Prishtinë, nga babai H. dhe nëna M. e gjinisë M., me vendbanim në rrugën “.....”, fshati B., Komuna e Prishtinës, i martuar, me profesion biznesmen, me gjendje të mesme ekonomike, ka të kryer nivelin master në fakultetin juridik, me numër personal “.....”, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

**Në kuptim të nenit 363 paragrafi 1, nën paragrafi 1.3, të KPPK-së,**

### LIROHET NGA AKUZA

#### Sepse:

Me datë 04.02.2024 rreth orës 13:00 në rrugën “ Fan Noli “ në Ferizaj, i pandehuri me qëllim të frikësimit dhe shkakimit të ankthit e kanos seriozisht të dëmtuarin I.A, lidhur me një

mosmarrëveshje rreth një borxhi, pasi që i dëmtuari kishte punuar në kompaninë e ndërtimit “ Altina Group ” në shtetin e Malit të Zi, me pronar B.B, në atë mënyrë që i pandehuri fillimisht e kishte thirrur në telefon të dëmtuarin duke e ofenduar me fjalë më banale si: “ ti q... ropt, ta q... ferizajlin e nanës” e pastaj e kishte kanosur me fjalët me përmbajtje kërcënuese duke i thënë “ku të shoh ka me të vra, shko në polici ose ku dush ti”, me ç’rast kjo kanosje ka shkaktuar shqetësim, frikë dhe pasiguri tek i dëmtuari.

**Pasi që nuk është provuar se ka kryer veprën penale Kanosja nga neni 181, paragrafi 2, të KPRK-së.**

- I dëmtuari I..A për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.
- Shpenzimet e procedurës penale, shpenzimet e paushallit gjyqësor si dhe taksa për kompensimin e viktimave të krimit bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

## **A r s y e t i m i**

### **Historiku i procedurës**

Prokuroria Themelore në Ferizaj-Departamenti i Përgjithshëm, me Aktakuzën PP/II.nr.254/24 të datës 05.03.2024, e ka ngarkuar të akuzuarin B.B me vendbanim në rrugën “.....”, fshati B.Komuna e Prishtinës, për shkak të veprës penale Kanosja nga neni 181, paragrafi 2, të KPRK-së.

Gjykata, duke vepruar në këtë çështje penale caktoi dhe mbajti seancën e shqyrtimit fillestar me datë 04.04.2024, ku i akuzuari në këtë shqyrtim ka deklaruar se nuk e pranon fajësinë për veprën penale me të cilën e ngarkon aktakuza.

Gjykata caktoi seancën e shqyrtimit gjyqësor me datë 23.01.2025, në të cilin shqyrtim të pranishëm ishin prokurori i shtetit Besnik Nuredini, i dëmtuari I..A dhe i akuzuari B.B.

Gjyqtarja e vetme gjykuese e udhëzoi të akuzuarin për të drejtat dhe detyrimet e tij në kuptim të nenit 319 paragrafi 1 dhe 2, të KPPK-së. Pasi që i akuzuari ka deklaruar se i ka kuptuar në tërësi udhëzimet e dhëna nga gjykata shqyrtimi gjyqësor ka vazhduar me leximin e aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit dhe pasi që gjykata është bindur se i akuzuari e ka kuptuar në tërësi

aktakuzën, në pajtim me nenin 321 paragrafi 1, të KPPK-së, i ka ofruar mundësinë përsëri që të deklarohet lidhur me fajësinë apo pafajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar.

I akuzuari në seancën e shqyrtimit gjyqësor është deklaruar i pafajshëm.

### **Fjala përfundimtare e palëve**

Prokurori i shtetit Besnik Nuredini, në fjalën përfundimtare ka deklaruar se konsideron se pas administrimit të provave personale dhe materiale gjate këtij shqyrtimi gjyqësor dhe vlerësimit të tyre veç e veç dhe të gjitha se bashku është vërtetuar dyshimi i bazuar mire se i akuzuari B.B ka kryer veprën penale të përshkruar në aktakuzë. Se i akuzuari ka kryer këtë vepër penale, se ditën kritike ka vepruar me qëllim të frikësimit dhe kërcënimit të të dëmtuarit I..A kjo është vërtetuar nga dëshmia e të dëmtuarit i cili para gjykatës dha dëshminë e tij duke mos rënë ndesh me asnjë fjalë të vetme, që nga deklarimi i tij në polici, si dhe tani në këtë shqyrtim gjyqësor.

Përderisa kishte qenë duke qëndruar në shtëpi e kishte thirrur në telefon i akuzuari, fillimisht duke e ofenduar me fjalët më banale e pastaj i kishte kërkuar llogari i dëmtuari pse po me ofendon, i akuzuari kishte ndërprerë telefonatën duke mos dashur të kontaktojë me të e pastaj i dëmtuari duke e ndjere veten të shqetësuar e kishte ftuar në telefon për të sqaruar lidhur me ofendimet, aty i akuzuari përveç që kishte vazhduar ofendimet tutje edhe e kishte kërcënuar me fjalë kërcënuese të përshkruara në aktakuzë. Se i akuzuari ka kryer këtë vepër penale është vërtetuar edhe me prova tjera siç është komunikimi përmes rrjetit social, por që i akuzuari duke dashur të iu shmanget përgjegjësisë penale nuk e pranon se ka kryer veprën penale si në aktakuzë dhe atë i njëjti në momentin që është ftuar nga policia e Kosovës për tu intervistuar duke e parë se në asnjë mënyrë nuk mund ti shmanget përgjegjësisë penale duke u përballur me prova të pakontestuara dhe atë nga dëshmia e të dëmtuarit që ishte edhe sot shumë bindes, i njëjti shfrytëzon të drejtën për tu mbrojtur në heshtje vetëm e vetëm për tu mos u sqaruar asnjë fakt lidhur me rastin edhe përkunde provave të pakontestuara.

Andaj, mbi bazën provave dhe dëshmive të ligjshme të elaboruara më lartë kërkohet nga gjykata që të akuzuarin B.B ta gjej dhe shpall fajtorë për veprën penale që i ngarkohet dhe të njëjtit ti shqipton një sanksion penal me të cilin do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitat e KPRK-së.

I dëmtuari I..A në fjalën përfundimtare ka deklaruar se përkrahë fjalën përfundimtare të prokurorit të shtetit dhe diçka më tepër nuk ka se çka të shtoj.

I akuzuari B.B në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: nuk kam diçka tjetër për të shtuar, përpos atyre që i thash në fjalën hyrëse dhe në mbrojtjen time, dhe se nuk e ndjej veten fajtorë për këtë vepër penale.

### **Mbrojtja e të akuzuarit**

I akuzuari B.B pas udhëzimeve të dhëna nga gjyqtarja e vetme gjykuese, i akuzuari në mbrojtjen e tij të dhënë në shqyrtimin gjyqësor të datës 23.01.2025, ka deklaruar se nuk është e vërtete se më datë 04.02.2024, ta ketë ftuar në telefon të dëmtuarin I..A, pasi që ky një natë më herët më datë 03.02.2024, ka qenë jashtë vendit dhe ai përmes “Viber” i ka dërguar video të të akuzuarit dhe të veturave të tija, duke i thënë se ka me i postuar në faqen e firmës së të akuzuarit dhe në internet, pra e kam kontaktuar në telefon që të sqarohet se nga kush i ka marrë këto video pasi që në ato video shihesha unë dhe dy persona të tjerë. Deklaron se i njëjti e ka kërcënuar se do ti publikoj ato video. Pas kësaj telefonate prap e ka ftuar në telefon ku ishte duke u kthyer nga Shqipëria, duke e fyer dhe sharë në telefon dhe vetëm i ka thënë “në rregull kur të kthehem i sqarojmë këto gjera” sepse dua te shtoj faktin se unë nuk isha i vetëm në veturë. Unë nuk kam kurrfarë obligimi ndaj I..A.

Deklaron se i kujtohet që ka qenë dy herë në Stacion Policor, por deklaratë nuk ka dhënë pasi që është mbrojtur në heshtje. Shton se është e vërtetë se më datë 04.02.2024 rreth orës 13:00 ka komunikuar në telefon me të dëmtuarin I..., sepse ai e ka ftuar, shton se nuk është e vërtetë se gjatë bisedës ta ketë ofenduar me fjalë banale e pastaj ta ketë kërcënuar me fjalët “*ku të shoh kam me të vra*”, si dhe mohon faktin që ta ketë kanosur për shkak të një borxhi.

Tutje deklaron se i kujtohet se me të dëmtuarin dhe punëtorët është takuar tek kafiteria “Missini” në Ferizaj, pastaj ata janë kthyer në Mal të Zi dhe paratë i kanë marrë tek investitori. Edhe njëherë mohon faktin se ta ketë sharë të dëmtuarin me fjalët “*ty robt \*\*\**”, madje shton se kur ja ka dërguar videon në viber ja ka kthyer me fjalët “*hahahaha*” si dhe edhe njëherë deklaron se nuk është e vërtetë se kur e ka thirrur i dëmtuari të ia ketë thënë fjalët “*ku të shoh kam me të vra*”. Shton se në asnjë moment nuk e ka kanosur te dëmtuarin I..A, pikërisht ky ka qenë ai që e ka shantazhuar me një video të tij se do të ia publikojë.

### **Provat e paraqitura në shqyrtim gjyqësor**

Pasi që i akuzuari, nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale me të cilën e ka ngarkuar aktakuza, gjykata ka bërë paraqitjen provave dhe pas vlerësimit të tyre një nga një dhe duke i ndërlidhur

reciprokisht njëri me tjetrin, në kuptim të dispozitës së nenit 360 paragrafi 1 dhe 2, të KPPK-së, vërtetoi gjendjen faktike të përshkruar hollësisht në dispozitivin e këtij Aktgjykimi.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar përmes provave të prezantuara në shqyrtimin gjyqësor dhe atë nga:

- Dëshmia e të dëmtuarit – dëshmitarit I..A

#### **Nga provat materiale:**

- Fotografi të bisedave elektronike përmes rrjetit social “Viber” ndërmjet B.B dhe të dëmtuarit-dëshmitarit.

#### **Vlerësimi i provave të prezantuara në shqyrtim gjyqësor**

Në shqyrtimin gjyqësor në këtë çështje penale, gjykata konform nenit 7 dhe 360, të KPPK-së, saktësisht dhe në mënyrë të plotë vërtetoi faktet që janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm, me vëmendje dhe përkushtim maksimal, profesional dhe me përkujdesje të njëjtë vërtetoi faktet kundër të akuzuarit, si dhe ato në favor të tij, duke i mundësuar të akuzuarit shfrytëzimin e të gjitha fakteve dhe provave që janë në favor të mbrojtjes dhe me ndërgjegje vlerësoi çdo provë një nga një dhe në lidhje me provat tjera dhe në bazë të vlerësimit të tillë, ka nxjerr përfundimin lidhur me faktet konkrete të vërtetuara.

#### **Vlerësimi i dëshmisë së dëshmitarit dhe provave materiale të paraqitura në shqyrtimin gjyqësor**

Fillimisht para se të vlerësohet dëshmia e dëshmitarit-të dëmtuarit dhe provat tjera materiale është e nevojshme që të qartësohet se gjatë shqyrtimit gjyqësor janë vërtetuar në mënyrë të pakontestueshme faktet në vijim:

-Se i dëmtuari I..A ka qenë i punësuar tek B.B, si punëtor fizik, për ndërtime në Malin e Zi.

Se i dëmtuari dhe i akuzuari kanë shkëmbyer disa biseda mes tyre, përmes rrjetit Viber.

Gjyqtarja e vetme gjykuese tutje ka vazhduar me vlerësimin e dëshmisë së dëshmitarit-të dëmtuarit I..A.

#### **Dëshmia e të dëmtuarit - dëshmitarit**

Nga dëshmia e të dëmtuarit-dëshmitarit I..A e dhënë në shqyrtimin gjyqësor më datë 23.01.2025, i cili ka deklaruar se i kujtohet që ka dhënë deklaratë në Stacion Policor në Ferizaj më datë 15.02.2024 dhe qëndron në tërësi pranë asaj deklarate. Deklaron se më datën 04.02.2024 ka qenë në shtëpi duke ngrënë mëngjes, dhe në telefon përmes rrjetit Viber e ka ftuar i akuzuari duke e pyetur se kush është ai person që po më shpërndan video nëpër telefona celular dhe po ashtu ka filluar duke e sharë me familje – robt dhe aty menjëherë e ka mbyll telefonin dhe për të mos i shqetësuar fëmijët ka dalur jashtë dhe e kam thirrë në telefon B... që të mirrem vesh se për çka e fyu në telefon, i njëjti vazhdoi me fjal të njëjta duke i thënë *“ku të shoh pa të vra nuk kam me lone, ndash shko në polici ndash ku te duash”*, dhe pas kësaj normalisht e kam ndjere veten të frikësuar.

Deri tek kjo mosmarrëveshje ka ardhur për arsye se B.B me ka mbetur borxh në vlerë prej 505 euro.

Tutje deklaroi se është i sinqertë në deklaratimet e tij dhe se nuk është e vërtetë që kur e ka telefonuar në telefon të akuzuarin ta ketë fyer me fjalë të ndryshme, me familje dhe grua. Dëshiron që sot të merr fund kjo çështje penale, i bashkëngjitet ndjekjes penale dhe do të paraqes kërkesë pasurore juridike. Burimi sot e asaj dite me ka mbetur borxh në vlerë prej 505 euro dhe po ashtu është në dijeni që borxhin e mbetur nga ana e Burimit do të mund ta vazhdoj procedurën civile.

Këtij deklarami gjyqtarja e vetme gjykuese nuk i fali besimin, pasi që i nuk ishte i përqendruar në deklaratimet e tija, nuk jepte hollësi apo detaje lidhur me bisedën e bërë mes tij dhe të akuzuarit, apo edhe shkakun e saktë të zhvillimit të kësaj bisede, i njëjti tërë deklaramin e tij e mbështet në faktin se këto fjalë i janë thënë vetëm atij pra të dëmtuarit dhe atë përmes kontaktit telefonik të zhvilluar mes tyre, e që ka qenë pikërisht i dëmtuari ai i cili e ka kontaktuar në telefon të akuzuarin. Po ashtu gjykata këtij deklarami nuk i fali besimin për faktin se i dëmtuari ka deklaruar se deri tek kjo kanosje ka ardhur për shkak të borxhit që i kishte i akuzuari të dëmtuarit, ndërkaq në pyetjet e bëra nga ana e të akuzuarit në drejtim të të dëmtuarit, i dëmtuari pranon faktin se ka qenë pikërisht i dëmtuari ai i cili e ka kontaktuar të akuzuarin dhe ka qenë pikërisht i dëmtuari ai i cili në rrjetin “Viber” i ka shkruar të akuzuarit se *“nëse deri të hënën nuk mi jep paratë, kam me t’i ba publike foto dhe videot e bëra”*.

Nga të gjitha provat por edhe tërë shqyrtimi gjyqësor në asnjë mënyrë gjykata nuk ka arritur të vërtetoj faktin se i akuzuari të ketë kryer veprën penale me të cilën e ngarkon aktakuza apo kanosur të dëmtuarin.

Përmes provës materiale fotografi të bisedave elektronike përmes rrjetit social “Viber” ndërmjet të akuzuarit B.B dhe të dëmtuarit-dëshmitarit, është vërtetuar se i akuzuari ka zhvilluar bisedë me të dëmtuarin edhe në lidhje me një obligim monetar mes tyre, e që në lidhje me këtë fakt gjykata i ka njoftuar palët, për realizim të kërkesave pasurore-juridike, në kontest juridiko-civil.

Andaj bazuar në dëshminë e të dëmtuarit – dëshmitarit, si dhe provën materiale të administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor, nuk është vërtetuar në asnjë mënyrë së në veprimet e të akuzuarit përmbushen elementet e veprës penale me të cilën akuzohet.

### **Vlerësimi i mbrojtjes së të akuzuarit**

Gjykata vlerëson se mbrojtja e të akuzuarit B.B, ishte konsistente dhe karakterizohet me mbrojtje të logjikshme, të natyrshme, për më tepër mbrojtja e tij është në harmoni dhe e mbështetur me të gjitha provat tjera të prezantuara, si dhe me dëshminë e të dëmtuarit-dëshmitarit. I akuzuari në mbrojtjen e tij nuk e mohon faktin se ka pasur komunikime me të dëmtuarin I.A, por mohon faktin se gjatë bisedës me të njëjtin ta ketë kërcënuar apo kanosur. Sa i përket pjesës së bisedës së zhvilluar, e ka arsyetuar me faktin se e tërë biseda është zhvilluar si shkak i disa fotografive që i dëmtuari ja ka përcjellë në rrjetin “Viber” disa fotografi të tij dhe të veturave të tij, duke i thënë se “kam me ti bo publike të hënën nëse nuk mi jep paratë dhe do të ia postoj në faqen e firmës dhe në internet”, e që i akuzuari ia ka kthyer vetëm me fjalët “hahahah”. Për gjykatën kjo deklaratë ka gjetur mbështetje edhe në provat materiale siç janë fotografitë e bisedave elektronike përmes rrjetit social “Viber” ndërmjet të akuzuarit dhe të dëmtuarit-dëshmitarit, ku janë të evidentuar bisedat ashtu siç në detaje e ka sqaruar edhe i akuzuari, ku në një moment i njëjti i ka thënë “ka me ti bo publike të hënën nëse s’mi jep paratë....” dhe i akuzuari të i ja ketë kthyer vetëm me fjalët “hahahah”.

Nga të gjitha këto që u thanë më lartë e duke marrë parasysh posaçërisht faktin se Gjykata me rastin e vendosjes është e obliguar që të provoj të gjitha faktet në mënyrë të gjithanshme dhe të pa kontestueshme, në favor dhe disfavor të akuzuarit, e posaçërisht këtë duke e ndërlidhur me nenin 3 të KPPK-së, *parimin e prezumimit të pafajësisë dhe parimin in dubio pro reo*, se mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose për zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit penal interpretohen në favor të të pandehurit dhe të drejtave të tij sipas këtij Kodi dhe sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, kurse në ndërlidhje të kësaj po ashtu duke pasur parasysh faktin se të gjitha argumentet që janë “*in peius*” ndaj të akuzuarit duhet të vërtetohen me siguri të plotë përkatësisht përtej dyshimit të arsyeshëm (*beyond reasonable doubt*) dhe nëse nuk arrihet një diçka e tillë duhet konsiderohen se nuk ekzistojnë kurse për

argumentet që janë “*in favorem*” ndaj të akuzuarit merren se ekzistojnë edhe atëherë kur janë vërtetuar me probabilitet.

Për më tepër është e pa diskutueshme se mbi kënd bie barra e provës për fajësinë e të akuzuarit dhe çdo veprim tjetër i Gjykatës do të kuptohet si e kundërt dhe në këtë mënyrë lëvizje e barrës së provës nga organi i akuzës në të akuzuarit, e cila është në kundërshtim esencial të njërit prej parimeve fundamentale të procedurës penale e përcaktuar me nenin 7 të KPPK-së dhe e garantuar edhe me nenin 6.2 të KEDLNJ.

### **Baza ligjore**

Sipas nenit 181 paragrafi 2 të KPRK-së, për t’u kryer kjo vepër penale parashihet:

**Paragrafi 2.** Kushdo që seriozisht i kanoset personit tjetër me fjalë, vepra apo gjeste se do ta privojë nga jeta ose se do t’i shkaktojë lëndim të rëndë trupor, se do ta rrëmbejë ose privojë nga liria ndonjë person tjetër ose se do ta dëmtojë me armë zjarri, me shpërthim ose me mjete të tjera të rrezikshme, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.

Nga kjo dispozitë ligjore, forma themelore e kësaj vepre penale ekziston kur kryesi i veprës penale (në rastin konkret kryesi), e kanos të dëmtuarin se do ti shkaktoj lëndim trupor, se do ta rrëmbeje ose privojë nga liria ose do ta dëmtoj me armë zjarri.

Sipas vlerësimit të gjykatës, në rastin konkret elementet e kërkuara sipas dispozitës ligjore të nenit 181 paragrafi 2 të KPRK-së, bazuar në deklaratimet e të akuzuarit, deklaratimet e të dëmtuarit – dëshmitarit si dhe fotografive, nuk janë përmbushur dhe atë për faktin se me asnjë provë të vetme nuk është arritur të vërtetohet se i akuzuari e ka kanosur të dëmtuarin I..A me fjalët “*ku të shoh pa të vra nuk kam me lone, ndash shko në polici ndash ku te duash*”, e që në këtë rast nuk është përmbushur forma themelore e kësaj vepre penale.

### **Kërkesa pasurore-juridike dhe shpenzimet e procedurës**

Në kuptim të nenit 462 paragrafi 3 të KPPK-së, i dëmtuari I..A për realizimin e kërkesës pasurore – juridike udhëzohen në kontest civil.

Konform nenit 453 par.1 të KPPK-së, shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve të kësaj gjykate.



Në bazë të së theksuarës më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM,**  
**DIVIZIONI PENAL**

**2024:074857, datë 12.02.2025**

**Zyrtare ligjore**

Egzona Livoreka

**Gjyqtarja e vetme gjykuese**

Fitore Krivanjeva-Daci

**KËSHILLA JURIDIKE**: Kundër këtij Aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve, pas pranimit të kopjes me shkrim të këtij Aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj.